

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë-ekonomiko financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 182, datë 26.12.2014.

Në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 844/8, datë 26.12.2014, dërguar z. Fatri Islamaj, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhteme

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, funksionon në bazë të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Punonjësit administrativë të gjykatës, veprojnë dhe realizojnë detyrat e tyre në mbështetje të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore”, miratuar me Urdhrin nr. 1830, datë 03.04.2001, të Ministrit të Drejtësisë. Më datën 17.07.2013, ka hyrë në fuqi Ligji “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, nr. 109/2013, datë 01.04.2013 i cili është shfuqizuar nga vendimi nr. 10, datë 06.03.2014 i Gjykatës Kushtetuese, për arsye të cenimit të parimit të ndarjes së pushteteve.

Mbi këtë bazë ligjore konstatohet se struktura dhe organika e Gjykatës miratohet direkt nga Ministri i Drejtësisë, pa marrë një mendim ose propozim nga Kryetari i Gjykatës apo Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, si institucioni përgjegjës për mirë funksionimin e këtij sistemi të drejtësisë. Kjo situatë gjykohet se ka shkaktuar dhe ngarkesën e lartë të çështjeve për çdo gjyqtar dhe pamundësi të përballimit me staf administrativ të problematikave të përditshme të administrimit gjyqësor. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana e gjykatës të hartohet dhe të dërgohet pranë Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë, në fund të çdo tremujori një raport mbi nevojat për personel administrativ dhe financiar të argumentuar në baze të ngarkesës individuale sipas gjyqtarëve dhe llojeve të çështjeve të gjykuara prej tyre, dhe bazuar në detajim të plotë të detyrave të gjithsecilit duke evidentuar mangësitë dhe problemet që hasen gjatë administrimit të punës në institucion. Ky raport gjykojmë se do të shërbejë si një nxitje pozitive për të adresuar problematikave të evidentuara të mungesës së kapaciteteve njerëzore në përballimin e funksioneve kryesore të gjykatës.

Ndërkohë të merren masa që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referencë të Ligjit 9877 datë 18.02.2008, i ndryshuar, neni 18, pika f/g, të hartojë rregullore mbi aspekte të funksionimit të saj, të përcaktojë ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe aspekte të tjera që sigurojnë mirëfunksionim të gjykatës.

Brenda datës 31/03/2015

2.a Auditimi konstatoi parregullsi në evidentimin dhe ndjekjen e të ardhurave që krijohen nga ky institucion, kështu u konstatua se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën objekt auditimi janë dhënë 429 vendime penale të formës së prerë, të cilat përmbajnë edhe dënime me gjobë, që përfaqëson të ardhur buxhetore që duhet të derdhet 100% në buxhet.

U evidentua se nuk është mbajtur dhe nuk është ndjekur llogaria përmbartimore, duke sjellë mungesë të pasqyrimin të kësaj të ardhure në pasqyrat financiare, e konkretisht: vetëm për vitin 2013 janë dhënë 308 vendime penale të formës së prerë dhe vlera e dënimeve me gjobë është 39,447,000 lekë, ndërsa për periudhën 01.01.2014-31.06.2014 janë dhënë 121 vendime penale dhe vlera e dënimeve me gjobë është 12,362,000 lekë. Këto vlera nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare duke sjellë si pasojë edhe pamundësi ndjekje dhe mbledhje të këtyre të ardhurave.

2.b Gjithashtu nga auditimi me zgjedhje konstatuam se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë marrë 8 vendime gjyqësore të ndërmjetme për palët gjatë seancës gjyqësore me vlerë 220.000 lekë. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren të gjitha masat nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në mbështetje të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, që të evidentohen këto lloj vendimesh dhe të bashkëpunohet me institucionet përkatëse në mënyrë që të sigurohet realizimi i këtyre fondeve në buxhetin e shtetit. Të merren masa që të regjistrohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë impakt financiar për institucionin dhe të pasqyrohen ato në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Nga auditimi me zgjedhje, lidhur me realizimin e të ardhurave në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është konstatuar:

a. Në 87 vendimeve të formës së prerë të dhëna në vitin 2013 si dhe 74 vendime gjyqësore të formës së prerë të dhëna në 6-mujorin e parë të vitit 2014, me objekt detyrimet që rrjedhin nga kontratat e huasë (nenet 1050-1055), u konstatua mos arkëtimi i tarifave të plota gjyqësore, kjo në kundërshtim me Udhëzimi nr. 13, datë 12.2.2009, i ndryshuar, duke sjellë të ardhura të munguara, në vlerën 850,200 lekë, 120 Euro dhe 250 USD për vitin 2013 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2014 në vlerën 166.351 lekë, 255 Euro.

b. Në 12 kërkesë padi për vitin 2013 dhe të 5 kërkesë padi për 6-mujorin e parë të vitit 2014, me objekt detyrimet që rrjedhin nga kontratat bankare (nenet 1024-1049 të K.C), u konstatua mos arkëtimi i tarifës së plotë gjyqësore, kjo në kundërshtim me Udhëzimi nr.13, datë 12.2.2009, i ndryshuar duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 660.000 lekë.

c. Në 67 kërkesë padi të audituara për periudhën 2013-Qershor 2014, u konstatuan 48 kërkesë padi ku nuk janë të evidentuara shpenzimet për avokatët e seancës, nga ku shpenzimet llogariten minimalisht në vlerën 1,920,000 lekë; vetëm 19 kërkesë padi kanë të specifikuara shpenzimet për ekspertët, duke mos dhënë detaje për praninë e ekspertizës në çështjen gjyqësore; vetëm 10 kërkesë padi kanë të evidentuara shpenzimet për njoftimet dhe shpalljet, nga ku shpenzimet për to janë minimalisht në vlerën 5,700 lekë (100 lekë për 1 njoftim). Në këto kërkesë padi nuk evidentohet procedura se si veprohet me mbledhjen dhe shpërndarjen e këtyre shpenzimeve, si dhe nuk përcaktohen nga institucioni përgjegjës në raste të mos arkëtitimit të shpenzimeve. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që të saktësohet, formalizohet dhe unifikohet formati i llogaritjes së shpenzimeve gjyqësore dhe kodifikimi i tyre sipas gjyqtarëve, të mundësohet shtimi i një opsioni në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, ku të evidentohet vlera e objektit të padisë, tarifa gjyqësore dhe pagesa e saj, në mënyrë që të sigurohet kontrolli i kësaj të ardhure.

E gjykojmë të rëndësishme që të vendosen procedura operationale për kontrollin e pagesave të tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore dhe përfshirjen e këtij kontrolli si një tregues për punën e cdo gjyqtari. Ky tregues të kërkohej që të bëhet pjesë e vlerësimit të punës së gjyqtarëve nga KLD.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i veprimeve të llogarisë bankare, ku pasqyrohen arkëtimet e bëra në lidhje me tarifën e paguara nga kryerja e veprimeve gjyqësore, u konstatuan kthime të tarifave gjyqësore palëve paditëse dhe personave të tjerë, të cilët nuk janë të pajisur me prokurë përfaqësimi, në vlerën 2,682,056 lekë. Kjo shumë përbën dëm ekonomik, pasi veprimi bie në kundërshtim me Udhëzimi nr. 13, datë 12.2.2009, i ndryshuar, pika 8: “Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore...”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga Dega e Buxhetit, për të kryer veprimet konform Udhëzimit të përbashkët nr. 13, datë 12.2.2009, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, i ndryshuar, pika 8 dhe gjithmonë me miratim të Titullarit të Institucionit.

Në vijimësi

5. Nga auditimi i dhënies me qira, të një sipërfaqeje prej 80 m², u konstatua mungesa e dokumentacionit, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 164 datë 7.03.2007 “Për dhënien me qira dhe emfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa për plotësimin e dosjes me praktikën e plotë dokumentare të cilësuar më lart, në të kundërt, të shfuqizohet kontrata përkatëse në mbështetje të VKM-së nr.164 datë 7.03.2007 “Për dhënien me qira dhe emfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar.

Brenda datës 31/12/2014

6. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve publike u konstatuan të meta, të cilat mund të ishin eliminuar nëqoftëse do të funksiononte rregullisht në autoritetin kontraktor si strukturë me vete Njësia e Prokurimit Publik. Kjo njësi është shumë e domosdoshme duke parë edhe mangësitë e të metat e konstatuara nga grupi i auditimit për prokurimet e blerjeve të mallrave e shërbimeve të vogla. Me organizimin e deri tanishëm ky autoritet kontraktor ose duhet t’ja delegojë ndonjë autoriteti tjetër kontraktor, si fjala vjen ZABGJ-së, në të kundërt, të funksionojë njësi e prokurimit e rregullt konform VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V-Zhvillimi i procedurave, pika 1, “Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim”, germa (b), që cilëson: “Çdo autoritet kontraktor ngre një njësi prokurimi, e cila duhet të administrojë, në mënyrë të vazhdueshme, procesin e prokurimit. Në rast mungese personeli, titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, mund t’ua ngarkojë detyrën e njësisë së prokurimit nëpunësve të sektorëve të tjerë ose mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore....”.

Në dy raste të audituara, tenderët duhej të ishin anuluar, pasi kriteret nuk plotësoheshin nga të gjithë operatorët ekonomikë (për devijime të vogla, por të paevidentuara në raportin përmbledhës). Po kështu në dosjet e tenderit nuk administroheshin kërkesat për mallra nga sektorët e ndryshëm të institucionit, të cilat do të shërbenin për llogaritjen e fondit limit. Në të gjitha rastet, Komisioni i argumentimit të fondit limit, nuk ka dokumentuar kërkesat për nevojat për mallra nga sektorë të ndryshëm të institucionit si dhe në një rast (rikonstruktion zyresh) ishin vendosur kriteret e veçanta për kualifikim të pastuduara nga ekspertë.

Për këtë është rekomanduar që:

Domosdoshmërinë e ngritjes së njësisë së prokurimit për të siguruar një ecuri normale të proceseve të prokurimit të shërbimeve dhe mallrave në këtë institucion. Sugjerojmë që në rastet kur nuk ka specialistë të fushës brenda institucionit për përcaktimin e specifikimit teknike dhe kërkesave për kualifikim, të aktivizohen struktura të specializuara jashtë Autoritetit Kontraktor.

Në çdo rast, komisioni i argumentimit të fondit limit, duhet të dokumentojë kërkesat për nevojat për mallra nga sektorë të ndryshëm të institucionit si dhe autoriteti kontraktor për të ardhmen duhet të mbajë parasysh edhe mangësitë e trajtuara në këtë projektraport për të zhvilluar tenderë konform legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

7. Nga auditimi u konstatua se në Gjykatë pjesa më e madhe e pagesave të vjetërsisë së punës së gjyqtarëve kryhej mbi baza vetë deklarimi, pasi librezat e punës së gjyqtarëve janë pjesë e dosjeve personale të tyre që dokumentohen në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu konstatohet se listëpagesat që shoqërojnë urdhër shpenzimet, nuk kanë nënshkrimin e Përgjegjësit të Personelit, çka është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa për sigurimin e një kopjeje të dosjeve individuale të gjyqtarëve në mënyrë që të mundësohet dokumentimi i vjetërsisë së punës së tyre. Për këtë, të kërkohen zyrtarisht në Këshillin e Lartë të Drejtësisë apo ti drejtohen arkivës së Presidencës. Të merren masa që librezat e punës të cdo gjyqtari të mbahen në institucion.

Dokumentimi i listëpagesave dhe shoqërimi i tyre në Degën e Thesarit, të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore mbi MFK-në dhe me Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011. Sektori i financës nuk duhet të vijojë me pagesën e pagave të punonjësve, në mungesë të nënshkrimeve nga personat e duhur

Brenda datës 28.02.2015 dhe në vijimësi

8. Nga auditimi i zbatimit të ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u konstatua se:

Gjykata nuk ka hartuar Deklaratën e Misionit; Objektivat Strategjikë; apo struktura për shqyrtimin e riskut në institucion; nuk ekzistojnë rregullore ose kod etike të brendshme; mungojnë trajnimet lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në të gjitha nivelet e personelit të Gjykatës.

Pyetësi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2013, është dërguar në ZABGJ dorazi, jo i protokolluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003, "Për Arkivat", kreu X, pika 92/1, me nenin 15 të po këtij ligji, si dhe me nenin 19, dhe 182 të "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të hartohet Deklarata e Misionit, Objektivat Strategjikë dhe cdo kërkesë tjetër në referencë të Manualit për MFK-së, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave me nr. 8980, dt. 15.07.2010.

Të përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit, procedura dhe rregulla të qarta mbi komunikimin shkresor zyrtar, dhe rregullat për protokollimin dhe arkivimin e dokumentacionit dhe komunikimit institucional, sipas kërkesave të ligjit për arkivat. Lëvizja e dokumenteve brenda dhe jashtë Gjykatës të kryhet në përputhje me Ligjin "Për arkivat", si dhe me dispozitat ligjore që rrjedhin prej tij.

Brenda 31.03.2015

9. Nga auditimi i vërtetimeve të lëshuara nga gjyqtarët, për shërbimet e kryera nga avokatët e thirrur kryesisht, u konstatuan problematika procedurale, si: Raste kur në vërtetimet e seancave gjyqësore të lëshuara nga gjyqtarët përkatës të seancave, mungojnë datat e vërtetimeve; raste kur në vërtetimet e seancave gjyqësore të lëshuara nga gjyqtarët përkatës të seancave mungon numri i seancave të zhvilluara, për të cilat nuk mund të konkludohet për rregullshmërinë e pagesave për seance; U evidentuan raste kur mungojnë faturat e avokatëve për shërbimet e ofruara, por edhe në rastet kur ka fatura të paraqitura nga avokatët, ato janë të paplotësuara, nuk përmbajnë të dhënat e blerësit, nuk përmbajnë nënshkrimet e shitësit dhe të blerësit, as kodet identifikues të blerësit, në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr. 7928, dt. 27.04.1995, "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar". Vetëm për periudhën e audituar u evidentuan pagesa në mungesë të plotë të dokumentacionit duke sjellë minimalisht hapësira për evazion fiskal nga ana e avokatëve të thirrur kryesisht. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të hartohet procedura që do të mundësonte kontrollin e plotë të këtij shpenzimi që ka një zë material në buxhetet e gjykatës si dhe të përcaktohet qartë përgjegjësia e gjithsecilit në rast se evidentohen raste të pagesës së avokatëve në mungesë të plotë të dokumentacionit apo llogaritje përtej kuotave të përcaktuara të shpërblimit të tyre. Dega e Buxhetit të kryejë gjithë veprimet e duhura për kontrollin e cilësisë dokumentare të ardhur nga gjyqtarët mbi pagesën e avokatëve, përpara se të procedohet me pagesën e tyre.

Në vijimësi

10. Në përfundim të auditimit me të zgjedhur të dokumentacioneve të bankës dhe magazinave u konstatuan raste të cilat janë në kundërshtim me rregullat dhe legjislacionin në fuqi, e konkretisht:

i) mbajtja e ditarëve të regjistrimit të dokumentacioneve të magazinës dhe bankës nuk janë hartuar konform VKM nr. 783, datë 22.11.2006 dhe në planin unik kontabël të Ministrisë së Financave. Konstatuam se vlerat e regjistruara brenda për brenda ditarëve përkatës nuk kuadrojnë. Të gjitha urdhër shpenzimet e likuidimeve me bankë nuk janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe sistematike, ka kapërcime numrash të urdhër shpenzimeve, madje mungojnë edhe numra urdhër shpenzimesh të pa regjistruara. U konstatuan edhe raste ku urdhër shpenzimet kanë të njëjtin numër, por me data dhe përmbajtje të ndryshme. Veprimet e cituara bien ndesh edhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli

II “Menaxhimi i riskut të lidhur me aktivet”, paragrafët “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve dhe Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”.

ii) të gjitha fletë hyrjet e magazinës janë kontabilizuar pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar të mallrave, fatura tatimore apo ndonjë dokument tjetër të barasvlershëm. Gjithashtu të gjitha fletë daljet janë kontabilizuar pa u bashkëlidhur autorizimet, apo urdhër dorëzimet e drejtuesit të njësisë shpenzuese, veprime këto që bien ndesh me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”;

iii) u konstatuan raste të kontabilizimit të fletë daljeve të magazinës, në të cilat janë pasqyruar njëkohësisht si materiale shpenzime kancelari ashtu edhe mallra aktive të qëndrueshme, që qarkullojnë me kartela personale duke ekspozuar institucionin ndaj riskut operacional.

iv) janë kryer pagesa të telefonave fiks për 14 numra, nga të cilët 5 numra telefonash nuk përdoren, por për to paguhet çdo muaj vetëm tarifa e shërbimit për 1,600 lekë si dhe paguar harxhimin e ujit në mënyrë aforfe. Për 5 numra për 1 vit kryhen pagesa me një vlerë prej 115,200 lekë gjithsej, shpenzime të cilat janë pa efektivitetit. Gjithashtu me numrin e telefonit fiks është lidhur interneti ADSL me një vlerë mujore, duke përfshirë edhe tvsh-në prej 12 mijë lekë. Krahas këtij, interneti është lidhur edhe një linjë tjetër intraneti, nëpërmjet Kompanisë Abissnet Tiranë, me një vlerë mujore prej 11,280 lekë në muaj. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Dega e Buxhetit, të merren masa për zbatimin e rregullave dhe parimeve kontabël në njohjen dhe evidentimin e saktë të shpenzimeve materiale dhe të inventarëve. Të njihen dhe zbatohen me përpikmëri kërkesat që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin në institucionet publike. Të bëhet rregullimi i të gjithë defekteve dhe mangësive të konstatuara dhe ballafaquara me personat përgjegjës për një pasqyrim sa më të drejtë të inventarëve në qarkullim, në pasqyrat financiare të institucionit;

Veprimet ekonomike të pasqyrohen kontabilisht në mënyrë kronologjike e sistematike, bazuar në parimet kryesore të kontabilitetit. Të kontrollohet në fund të çdo muaji rakordimi me tepicën e konfirmuar nga dega e thesarit dhe të unifikohet raportimi i situacionit mujor me regjistrimet në ditarët e bankës;

Të gjendet mundësia e mbylljes së 5 numrave të telefonisë fikse që nuk përdoren si dhe për numrin e telefonit 042228906 të vendoset limiti përkatës si dhe një rregull i brendshëm i kontrollit të tij.

Realizimi i shërbimit të internetit dhe intranetit të kryhet mbasi të jetë bërë prokurimi publik për këtë lloj shpenzimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjatë auditimit të sistemit të kontrollit të aktiveve (inventarizimet fizike të vitit 2013), u konstatuan **i)** Parregullsi në kryerjen e inventarizimeve fizike të aktiveve dhe vlerave në magazinë të lidhura me përbërjen e komisionit për kryerjen e inventarizimeve fizike të aktiveve të qëndrueshme pasi në të është përfshirë edhe magazinieri, mungesën e deklaramit të konfliktit të interesit. Veprimet bien ndesh me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, paragrafët nr. 81 e 82, si dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005;

ii) Në kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve të qëndrueshme të dhomës penale dhe të dhomës civile nuk janë lënë gjurmë për fiksimin me procesverbal të numrit rendor të fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit; nuk janë bërë verifikimet fizike e cilësore të gjendjes së aktiveve dhe pasqyrimin të të dhënave të inventarizimit me procesverbalin përkatës si dhe përgatitjes së raportit lidhur me realizimin e inventarizimeve fizike të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre dhe gjendjes fizike;

iii) Në dosjet e inventarizimeve të aktiveve të qëndrueshme ekzistojnë vetëm fletët e inventarizimit sipas punonjësve që kanë në ngarkim aktivet. Në fletë inventarizimet e magazinës nuk ka asnjë firmë të anëtarëve të komisionit, madje as të vetë magazinierit. Vlera fizike e inventarizimit është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin kontabël të Dhjetorit 2013, aktivin e bilancit, Klasa 3 “gjendja e inventarit”, llogaria 31 “materiale”, ku ky inventarizim cilëson muajin Dhjetor 2013, në një kohë që urdhri është nxjerrë në Prill 2013 dhe pretendohet se inventarizimet janë kryer në prill të vitit 2013. Ndërsa për inventarizimet fizike të aktiveve të qëndrueshme sipas punonjësve që kanë në ngarkim aktivet apo objektet e tjera në sallat e gjyqeve, korridorët, etj., janë vendosur vetëm sasi të këtyre aktiveve fizike pa shënuar çmimet dhe vlerat përkatëse. Mos plotësimi i fletëve të inventarizimeve të aktiveve në sasi dhe vlerë, si fizik ashtu edhe kontabël, bie ndesh me UMF nr. 30, datë 27.12.2011,

paragrafi 82, madje është nëpunësi zbatues, që fillimisht duhet të listojë të gjitha aktivet për inventarizim, në bazë të të dhënave të regjistruara kontabël. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Dega e Buxhetit, të merren masa të kryhen inventarizimet fizike të vitit 2014 konform rregullave e legjislacionit në fuqi, duke e konsideruar realizimin e inventarizimeve një element të rëndësishëm kontrolli, në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë publike shpenzuese, i cili të kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.

Deri me datën 31/12/2014

12. Kemi konstatuar disa pagesa të bankës, të pa shoqëruara me praktika të plota dokumentare të shpenzimeve siç kërkon VKM nr. 783, datë 22/11/2006 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli II, paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”, pika 35. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me plotësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të munguar si dhe të mos kryhen pagesa pa u shoqëruar me dokumente të plota mbi transaksionet e ndodhura. Gjithashtu të kërkohej nënshkrimi i të gjitha praktikave nga personat përkatës dhe në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011

Në vijimësi

13. Në procedurat e zhvilluara të prokurimeve të blerjeve e shërbimeve vogla u konstatuan mangësi e shkelje të legjislacionit të prokurimeve publike të lidhura me mungesën e një regjistri analitik për mbajtjen e realizimit të prokurimeve me blerje e shërbime të vogla për çdo urdhër shpenzimi, me qëllim respektimin e kufirit maksimal të lejueshëm prej 400 mijë lekë. Përgjithësisht në tenderët e audituar për blerjet e shërbimet e vogla të zhvilluara nëpërmjet platformës elektronike, janë kërkuar kritere të pjesëmarrjes, kritere të vlerësimit dhe dokumente për tu paraqitur nga operatorët ekonomik për konkurrim, që nuk janë parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik në fuqi. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren të gjitha masat që zhvillimin e procedurës së prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin elektronik të prokurimeve, autoriteti kontraktor, ta konsiderojë të njëjtë me procedurat që ndiqen aktualisht në rrugë shkresore. Në këtë kuptim, nuk është e detyrueshme të plotësohen kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar apo kapaciteti teknik por, në çdo rast tek kushtet “të tjera” është e detyrueshme që të kërkohej e të plotësohen minimalisht të dhënat e objektit që do të prokurohet si, sasia, specifikimet teknike etj.

Në vijimësi

14. Nga auditimi mbi nxjerrjen e llogarisë vjetore, pasqyrave financiare (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive, u konstatuan parregullsi në plotësimin e pasqyrave financiare ashtu edhe të formularëve të bilancit të vitit 2013. Kështu pasqyrat financiare nuk janë sipas formateve të autorizuara nga Ministria e Financave, por janë ato të modifikuara nga vetë Dega e Buxhetit të Gjykatës, mungon ose nuk na u vu në dispozicion bilanci paraprak verifikues, me qëllim për të parë edhe procedurat e rakordimit. Pasqyrat financiare nuk janë shoqëruar me shënime shpjeguese për hartimin e llogarive të administrimit financiar të vitit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të tregohet një kujdes i veçantë në hartimin e pasqyrave financiare bazuar në standardet e kontabilitetit publik dhe në plotësinë e të dhënave dhe informacioneve që duhet të shoqërojnë këto pasqyra. Në çdo rast pasqyrat financiare duhet të shoqërohen edhe dokumentacionin mbështetës të veprimeve rregulluese të fund vitit bazuar në parimet bazë kontabël. Ndërkohë gjykojmë se mbajtja manuale e

kontabilitetit është një praktikë e tejkaluar dhe duhet të merren masa që të bëhet informatizimi i këtij procesi.

Në vijimësi

A/I) Për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor:

Nisur nga konstatimi se struktura dhe organika e Gjykatës miratohet direkt nga Ministri i Drejtësisë, pa marrë një mendim nga Kryetari i Gjykatës apo faktit se ka ngarkesë të lartë të çështjeve për çdo gjyqtar dhe pamundësi të përballimit me staf administrativ të problematikave të përditshme të administrimit gjyqësor. **Për këtë është rekomanduar që:**

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor të analizojë me kujdes ngarkesën dhe nevojat e gjykatës për personel gjyqësor dhe administrativ bazuar në detajim të plotë të detyrave të gjithsecilit duke evidentuar kapacitete e kufizuara që ka Institucioni dhe mbi bazë të kësaj ti kërkojë Ministrisë së Drejtësisë shtesë organike bazuar në këtë analizë.

Brenda datës 30.06.2015

Nisur nga konstatimet e këtij auditimi lidhur me mangësitë dhe problematikat e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sidomos në fushën e të ardhurave, si dhe problematikat e mbajtjes dhe ndjekjes së transaksioneve financiare jo në përputhshmëri të plotë me rregullat kontabël, mungesës së rakordimeve me Degën e Thesarit Tiranë, pasaktësive në hartimin e pasqyrave financiare vjetore etj, të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. **Për këtë është rekomanduar që:**

ZABGJ-ja të bëjë një auditim financiar në të gjitha gjykatat për dhënien e sigurisë lidhur me të dhënat e pasqyrave financiare të këtyre institucioneve. Gjithashtu të vendosë në programet e auditimit, si një objektiv të vetin kryesor, zbatimin dhe funksionimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në gjykatat e çdo niveli. Një kopje e këtij raporti të dërgohet edhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Nga ana e këtij institucioni të realizohen trajnime dhe takime ndërgjegjësimi mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për punonjësit e administratave të gjykatave.

Brenda datës 30.06.2015

B.MASA SHPËRBLIM DËMI:

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin me efekt negativ financiar:

1. Nga 4 fituesit e tenderave për vlerën totale prej **1,854,011 lekë**, porsa janë konstatuar mos kryerje të zërave të punimeve për dy objekte ndërtimi në vlerën prej 1,259,550 lekë si dhe mos arkëtim penaltetesh për sjellje malli me vonesë jashtë kushteve të caktuara në kontratat përkatëse për dy tenderë mallrash në vlerën prej 594,461 lekë, e konkretisht:

a. BOE konkurrues e fitues i tenderit “██████████” shpk& “██████████” në vlerën 605,250 lekë për diferenca në volume në objektin “Përshtatje e ndërtesës së ish Institutit të Kërkimeve Zooteknike në Laprakë me qëllim vendosjen e Dhomës Administrative”;

b. Operatori ekonomik konkurrues e fitues i tenderit “██████████” shpk në vlerën 654,300 lekë për diferenca në volume në objektin “Rikonstruksioni i arkivës, kryesekretarisë dhe dy sallave gjyqësore në Godinën Penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”;

c. Operatori ekonomik konkurrues e fitues i tenderit “██████████” shpk në vlerën 583,963 lekë si penaltet për mosdorëzim të mallit brenda afatit të përcaktuar në kontratë;

d. Operatori ekonomik konkurrues e fitues i tenderit “██████████” shpk në vlerën 10,498 lekë si penaltet për mosdorëzim të mallit brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

2.a Nga punonjësit e cilësuar në tabelën bashkëngjitur në vlerën totale prej **263,487 lekë** për parregullsitë në llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat.

2.b Nisur nga konstatimi se punonjësja [REDAKTUAR] në muajin Prill 2013, është paguar për 15 ditë raport, pra një ditë më tepër sesa është e ligjshme të paguhet nga ana e punëdhënësit si dhe gjyqtari [REDAKTUAR] është paguar për 20 ditë raport, pra 6 ditë më tepër sesa është e ligjshme të paguhet nga ana e punëdhënësit kërkojmë të merren masa dhe të sistemohen pagesat e kryera më tepër në drejtim të punonjësës [REDAKTUAR] dhe gjyqtarit [REDAKTUAR].

3. Për të gjitha konstatimet e tjera të lidhura me pasaktësi dokumentare në pagesat e realizuara sa trajtuar gjerësisht në faqet 9-24 dhe 42-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, i kërkohet Titullarit të Institucionit që të gjejë përgjegjësitë institucionale dhe të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave në të ardhmen si dhe të kërkohet nga Dega e Buxhetit zbatimi me rigorozitet i këtij rekomandimi.

C. MASA DISIPLINORE:

T'i bëhet **“Zgjidhja e menjëhershme e kontratës nga punëdhënësi”**, në zbatim të nenit nr. 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, për sa ka kryer veprime në kundërshtim me nenet nr. 23/1 dhe 24/1 të Kodit të Punës, **punonjësës [REDAKTUAR]**, me detyrë Kryetare e Degës së Buxhetit si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe Kryetares së Komisionit të Blerjeve e Shërbimeve të Vogla, trajtuar hollësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet si dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë:

-nga auditimi i debitimit dhe i kreditimit të llogarisë bankare, ku pasqyrohen arkëtimet e bëra në lidhje me tarifën e paguara nga kryerja e veprimeve gjyqësore, u konstatua se është debituar llogaria bankare duke iu kthyer tarifa gjyqësore palëve paditëse dhe personave të tjerë, të cilët nuk janë të pajisur me prokurë përfaqësimi, në vlerën 2,682,056 lekë, e cila përbën dëm ekonomik, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët nr. 13, datë 12.2.2009, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, i ndryshuar, pika 8;

-nga auditimi lidhur me realizimin e të ardhurave Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është konstatuar se në 87 vendime të formës së prerë të dhëna në vitin 2013 si dhe 74 vendime gjyqësore të formës së prerë të dhëna në 6-mujorin e parë të vitit 2014, me objekt detyrimet që rrjedhin nga kontratat e huas (nenet 1050-1055), u konstatua mos arkëtimi i tarifave të plota gjyqësore, kjo në kundërshtim me Udhëzimi nr. 13, datë 12.2.2009, i ndryshuar, duke sjellë të ardhura të munguara, në vlerën 850,200 lekë, 120 Euro dhe 250 USD për vitin 2013 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2014 në vlerën 166.351 lekë, 255 Euro. Gjithashtu në 12 kërkesë padi për vitin 2013 dhe të 5 kërkesë padi për 6-mujorin e parë të vitit 2014, me objekt detyrimet që rrjedhin nga kontratat bankare (nenet 1024-1049 të K. C), u konstatua mos arkëtimi i tarifës së plotë gjyqësore, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 660.000 lekë.

-mbajtjen e ditarëve të regjistrimit të dokumentacioneve të magazinës dhe bankës jo konform VKM nr. 783, datë 22.11.2006. Këto ditarë kanë njëkohësisht edhe regjistrime të të dhënave të ditarit të shpenzimeve, çka bie ndesh edhe me planin unik kontabël dhe monografisë-ditarë të Ministrisë së Financave. Në ditarët e daljeve të bankës dhe magazinës sipas metodës dyfishe, llogaritë që debitohen nuk janë llogaritë e shpenzimeve (602) e nënllogaritë e saj, pasi këto debitohen vetëm nëpërmjet ditarit të shpenzimeve, por janë respektivisht vetëm llogaritë 603 (për dalje materiale, inventar e mallra, 703 (për produkte të prodhuara), ose llogaritë 580, 401, 404, 421, 435, 431, 467, etj.,

-kontabilizimet e urdhër shpenzimeve të likuidimeve nëpërmjet bankës nuk janë kryer në mënyrë kronologjike dhe sistematike, pasi ka kapërcime numrash të urdhër shpenzimeve, madje mungojnë edhe numra urdhër shpenzimesh të pa regjistruara si dhe nuk janë shënuar në ditarin e kontabilizimeve numrat e tyre, por janë shënuar vetëm numrat rendorë në mënyrë progresive. Po kështu u konstatuan edhe raste ku urdhër shpenzimet kanë të njëjtat numra, por me data dhe përmbajtje të ndryshme.

Gjithashtu janë kontabilizuar urdhër shpenzime pa u vendosur data përkatëse si dhe raste, që për urdhër shpenzimet të plotësuara e të ndodhura në dosjen përkatëse, janë të pa kontabilizuara në ditarin e bankës, ose të kontabilizuara në ditarin e bankës por nuk ndodheshin urdhër shpenzimet me dokumentacion në dosjet përkatëse.

-kontabilizuar të gjitha fletë hyrjet e magazinës pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues të mallrave, fatura tatimore apo ndonjë dokument tjetër të barasvlershëm. Gjithashtu të gjitha fletë daljet janë kontabilizuar pa u bashkëlidhur autorizimet, apo urdhër dorëzimet e menaxherit të njësisë shpenzuese publike, si dhe u konstatuan raste të kontabilizimeve të fletë daljeve: me korrigjime të ndryshme, raste me numra të dyfishtë, veprime këto që bien ndesh me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”;

-mangësi gjatë kryerjes dhe mbylljes së procedurave të inventarizimeve fizike të aktiveve dhe vlerave në magazinë, si: nuk janë lënë gjurmë për fiksimin me procesverbal të numrit rendor të fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit; nuk janë bërë verifikimet fizike e cilësore të gjendjes së aktiveve dhe pasqyrimin të të dhënave të inventarizimit me procesverbalin përkatës si dhe përgatitjes së raportit lidhur me realizimin e inventarizimeve fizike të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre dhe gjendjes fizike; në dosjet e inventarizimeve të aktiveve të qëndrueshme ekzistojnë vetëm fletë inventarizimi personale të punonjësve, që kanë në ngarkim aktivet. Ndërsa për inventarizimet fizike të aktiveve të qëndrueshme të punonjësve, që kanë në ngarkim aktive apo objektet e tjera si salla e gjyqeve, korridori, etj., janë vendosur vetëm sasi të këtyre aktiveve fizike, pa shënuar të dhënat nga kontabiliteti si dhe pa shënuar çmimet dhe vlerat përkatëse.

-në procedurat e zhvilluara të prokurimeve të blerjeve e shërbimeve vogla u konstatuan mangësi e shkelje të legjislacionit të prokurimeve publike në fuqi,

-nga auditimi mbi nxjerrjen e llogarisë vjetore, pasqyrave financiare (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive, u konstatuan parregullsi në plotësimin e pasqyrave financiare ashtu edhe të formularëve të bilancit të vitit 2013, si: formatet e bilancit (pasqyrat financiare), nuk janë ato formate e pasqyra financiare të autorizuara nga Ministria e Financave, por janë ato të modifikuara nga vetë Dega e Buxhetit të Gjykatës, dhe të tjera të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT